



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA VENDORE E PËRMBARIMIT LUSHNJE

Nr.215 Regj

Lushnje, më 22.12.2023

VENDIM

(PËR SHPALLJEN E SHITJES NË ANKAND TË PASURISË SË PALUAJTËSHME)

Unë Mirel Gjolena, Përmbaues Gjyqësor pranë Zyrës Vendore të Përmbaimit Lushnje, pasi studiova materialet e dosjes përmbaimore me nr.215 Regj., datë 16.12.2021 në zbatim të “Titullit Ekzekutiv” nr.746 (2244), datë 13.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje,

KONSTATOVA:

Se më datën 16.12.2021 është regjistruar pranë Zyrës Vendore të Përmbaimit Lushnje kërkesa e (kreditorit) Luljeta Pali Sema së bashku me “Titullit Ekzekutiv” nr.746 (2244), datë 13.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, me palë:

- Kreditor: Luljeta Pali Sema
- Debitor: Arqile Rrapi Gjermani, Besnik Arqile Gjermani
- Me objekt: Kthim shume

Lidhur me ekzekutimin e këtij tituli ekzekutiv nga ana jonë kan vazhduar procedurat ligjore sipas dispozitave të Kodit të Proçedurës Civile dhe ligjit nr.8, datë 02.02.2023 “ *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbaimore Gjyqësor*”.

Pasuria me nr.22/1-Nd, volume 2, fq.168, Z.K 1047, me sipërfaqe 97 m², me adresë në fshatin Arrëz, Njësia Administrative Krutje, Lushnje.

Me urdhërin nr. 130 Regj., datë 26.05.2022 është vendosur sekuestro konservative në pasurinë e paluajtëshme nr.22/1-Nd, volume 2, fq.168, Z.K 1047, me sipërfaqe 97 m² me adresë në fshatin Arrëz, Njësia Administrative Krutje, Lushnje e rregjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrs , Drejtoria Vendore Lushnje në emër të debitorëve Arqile gjermani dhe Besnik Gjermani.

Me aktin teknik, Akt ekspertimi të ekspertes Znj. Tefta Jaupllari e cila i është bashkëngjitur titullit ekzekutiv nr.746 (2244), datë 13.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje ka përcaktuar vlerën e pasurisë së paluajtëshme: Pasuria me nr.22/1-Nd, volume 2, fq.168, Z.K 1047, me

sipërfaqe 97 m² me adresë në fshatin Arrëz, Njësia Administrative Krutje, Lushnje është 2 290 170 lekë.

Me shkrepën nr. Regj.215, datë 23.11.2023 në baze të nenit 567 të Kodit të Proçedurës Civile janë lajmëruar (debitorët) Arqile Gjermani dhe Besnik Gjermani se brenda 10 (dhjetë) ditëve të njoftimit nuk do të përmbushte detyrimin sendi i sekuestruar do të shitet në ankand.

Sipas akteve të administratuara në dosjen përmbarimore, rezulton se është paguar vetëm detyrimi prej 500 000 lekësh nga debitorët dhe nuk është përmbushur detyrimi prej 313 774 lekë.

Për këtë arsye:

Në bazë të neneve 586,569 e 570 të Kodit të Proçedurës Civile, ligjit nr.8, datë 022.02.2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor” dhe udhëzimit nr.5, datë 12.12.2012 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbaruesi gjyqësor”, unë Përmbarues Gjyqësor Mirel Gjolena.

VENDOSA :

1. Shpalljen e shitjes në ankand të pasurisë si më poshtë :

Pasuria me nr.22/1-Nd, volume 2, fq.168, Z.K 1047, me sipërfaqe 97 m² me adresë në fshatin Arrëz, Njësia Administrative Krutje e rregjistruar në emër të Besnik Gjermani dhe Arqile Gjermani.

Me këtë shpallje njoftohen të gjithë të interesuarit, duke i,

INFORMUAR SE :


1. Çmimi i sendit të paluajtshëm që shitet ka vlerën prej 2 290 170 lek, si dhe çmimi fillestar i ankandit të parë të hapur është 80 % (përqind) i çmimit të përcaktuar sipas aktit të ekspertimit të ekspertetes Tefta Jaupllari. Vlera e sendit të paluajtshëm është në shumën 2 290 170 lekë - 458 034 lekë = 1 832 136 lekë si dhe me këtë vlerë do të shpallet në ankandin e parë të hapur publik, sipas dispozitave të Kodit të Proçedurës Civile (neneve 568 dhe 570 të Kodit të Proçedurës Civile, si dhe udhëzimit nr.5, datë 12.12.2012 “ Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin ankandit nga përmbaruesi gjyqësor”).
2. Vendi ku do të zhvillohet ankandi i parë i hapur publik i shitjes së sendit është Zyra Vendore e Përmbarimit Lushnje, e cila gjendet në adresën: Lagja “Çlirim”, pranë ambjenteve të Gjykatës Adinistrative të Shkallës së Parë Lushnje, hyrja nga mbrapa.
3. Ankandi i parë i hapur publik për shitjen e sendit të paluajtshëm shpallet sot më datë 26.12.2023 dhe do të qëndrojë i publikuar deri më datë 09.01.2024 ditë e Martë, ora 16:00
4. Dorzimi i kërkesës për pjesëmarrje në ankandin e hapur public të parë do të pranohet në të gjithë afatin 15- ditorë dhe procesi përfundimtar i zhvillimit të ankandit do të

kryhet ne datë 09.01.2024, ditë e Martë duke u mbyllur në orën 16 :00 me mbarimin e orarit zyrtar.

5. Çdo ofertues që është i interesuar për blerjen e pasurisë në ankand është i detyruar të paraqitet personalisht dhe /ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij /saj me prokurë si dhe të dorzojë (brenda në zarf të mbyllur) në Zyrën e Përmbarrimit gjyqësor (Zyrën Përmbarrimore Lushnje) deri në orën 16:00, këto dokumenta:
 - a) kërkesën e tij/saj për pjesmarrje në ankand
 - b) b) faturën bankare të 10 % të garancisë për pjesmarrje në ankand (orgjinale)
 - c) c) Dokumentin e identifikimit (letërnjoftim ID ose Pasaportë)
6. Çdo ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të procedurave të shqyrtimit të ofertave, në datë 09.01.2024, ditë e Martë ora 16 :00 është i detyruar ti deponojë si garanci pranë Raiffeisen Bank Sh.a dega Lushnje , ne numërin e llogarisë 1200000030 të Zyrës së Përmbarrimit Lushnje një shumë të hollash të barabartë me 10% të çmimit të pasurisë të caktuar në shpallje. Kreditori nuk lë garanci në rast se kredia e tij kalon masën e garancisë.
7. Debitori dhe /ose përfaqësuesi i tij ligjor, përmbarruesi gjyqësor, si dhe personat e tjerë që listohen në nenin 709 të Kodit Civil , nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand.
8. Gazeta “Panorama” dhe Gazeta “Shqiptare”:, sipas detyrimit që rrjedh nga neni 568 i Kodit të Procedurës Civile këtë vendim detyrohen ta publikojnë 5 (pesë) ditë radhazi, në gazetat e tyre. Për shërbimin e kryer pala kreditore merr përsipër pagimin e shumës e cila sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile i ngarkohen debitorit.
9. Ky vendim hartohet në 12 (njëmbëdhjetë) kopje : 1 (një) kopje administrohet në dosjen përmbarrimore, 1 (një) kopje afishohet në ambjentet e Zyrës së Përmbarrimit Lushnje, 1 (një) kopje afishohet në vendin ku ndodhet ku ndodhet pasura e paluajtëshme (nëpërmjet Njësisë Administrative Krutje, Bashkia Lushnje), 1 (një) kopje i njoftohet debitorit, 2 (dy) kopje i njoftohetn kreditoritorëve, 3 (tre) kopje ju njoftohen Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Fier, Bashkisë Lushnje dhe Njësisë Administrative Krutje, Bashkia Lushnje për afishim në ambjentet e tyre publike, 1 (një) kopje dërgohet në Drejtorinë e Përgjithëshme të Përmbarrimit Tiranë si dhe 2 (dy) kopje iu njoftohen për publikim Gazetës “Panorama” dhe Gazetës “Shqiptare”

PËRMBARRUES GJYQËSOR

Mirel Gjoleja



KRYETAR I ZYRËS

Brikena Luto

